

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komp. Rajon Ujësjetës "Hidromorava" SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **nuk ka-26-118-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizimi, instalimi dhe programimi I Ujëmatësit Digjital DN 400**

### A N K E S Ë

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

\_\_\_\_\_ **OE "ROA GROUP L.L.C."** \_\_\_\_\_

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

\_\_\_\_\_ **Sallabajë-Lluzhan, p.n,** \_\_\_\_\_

(Adresa)

\_\_\_\_\_ **Podujevë** \_\_\_\_\_

(Vendi)

\_\_\_\_\_ **11050** \_\_\_\_\_

(Kodi postar)

\_\_\_\_\_ **+383 48262424** \_\_\_\_\_

(Numri Telefonit)

\_\_\_\_\_ \_\_\_\_\_  
(Numri i Faks-it)

\_\_\_\_\_ **Kastriot Nazifi** \_\_\_\_\_

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

\_\_\_\_\_ **roashpk@outlook.com** \_\_\_\_\_

(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_ **22.05.2026** \_\_\_\_\_

(Data e parashtrimit të ankesës)

  
\_\_\_\_\_ (Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Furnizimi, instalimi dhe programimi i Ujëmatësit Digjital DN 400**

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 21.01.2026 ndërsa hapja publike është bërë në datën 02.02.2026.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së përmes formularit B58 është bërë në datën 19.02.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 24.02.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datën 25.02.2026 ka publikuar vendimin ku e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë refuzim me date 06.03.2026 iu kemi drejtuar OSHP-së me ankesë.

OSHP me date 31.03.2026 ka nxjerre vendimin e vet dhe e ka kthyer lenden ne ri-vlerësim.

AK me datë 30.04.2026 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku të pakënaqur me këtë vendim, me datë 05.05.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 12.05.2026 e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohem OSHP-së me këtë ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.**

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja e tenderëve është bërë në datën 02.02.2026. Në procesverbalin e hapjes së tenderëve nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore.

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 21.01.2026 ndërsa hapja publike është bërë në datën 02.02.2026.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së përmes formularit B58 është bërë në datën 19.02.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 24.02.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datën 25.02.2026 ka publikuar vendimin ku e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë refuzim me date 06.03.2026 iu kemi drejtuar OSHP-së me ankesë.

OSHP me date 31.03.2026 ka nxjerre vendimin e vet dhe e ka kthyer lenden ne ri-vlerësim.

AK me datë 30.04.2026 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku të pakënaqur me këtë vendim, me datë 05.05.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 12.05.2026 e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohem OSHP-së me këtë ankesë.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së,
2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,
3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,
4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së,
5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,
6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së,
7. AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së si dhe nuk ka respektua as rekomandimet e vendimit të OSHP-së

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**1. AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së** pasi që gjatë procesit të Rivlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur aspak rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive dhe **ekonomike**. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave

dhe kritereve të parapara në Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Thirrja e përsëritur në ofertën tonë si të papërgjegjshme kinse për një gabim teknik të cilin e ka sqaruar dhe trajtuar edhe OSHP si dhe përkundër faktit që çmimi i ofertuar nga ne është më i ulët se sa ofertat konkurrenente, tregon se AK po e përdor vetëm si arsytim fiktiv këtë arsye për tentim të eliminimit të tenderit tonë. AK me këtë veprim po tenton ta vë në lajthitje opinionin, duke e keq interpretuar gabimin tonë minor tek titulli i deklaratës për specifikimet teknike njëherit nuk po e respekton as rekomandimin e OSHP-së që ky gabim është minor dhe i papërfillshëm. AK ka pranuar si të rregullta shumë mangësi tek tenderuesi i shpallur fitues që janë shumë më të mëdha se sa kjo që ka aplikuar tek ne dhe me këtë shihet se qëllimisht po tenton të na dëmtoj neve dhe buxhetin e vet AK-së.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë dhe marrë për bazë mënyrën se si ishin përshkruar kërkesat e dosjes së tenderit, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së duke mos ri vlerësuar tenderin tonë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, duke mos respektuar as rekomandimin e OSHP-së e madje duke mos administruar procedurën e prokurimit sipas neneve të cekura më lartë. Kjo tregon hapur se gjatë vlerësimit të tenderëve, AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

**2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së** pasi që gjatë rivlerësimit të tenderëve nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë. Kjo ka ardhur si pasojë e asaj kur AK e ka konsideruar të përgjegjshëm OE të shpallur fitues edhe pse ka shumë mangësi në tenderin e tijë ndërsa neve na ka eliminuar edhe pse deklarata jonë për specifikimin teknik posedon të saktë numrin e prokurimit dhe numrin e brendshëm si dhe e njëjta si dëshmi nuk ka qenë e kërkuar fare tek përshtatshmëria profesionale në FDT-së. Nga arsytimi për eliminim që na ka dërguar AK dhe pas krahasimit të tij me tenderin e OE të shpallur fitues, shihet se gjendja në tenderin e OE të shpallur fitues është e pa pranueshme sa i përket plotësisht të kritereve të kërkuara ndërsa ne kemi një gabim teknik minor që nuk ndikon fare tek plotfuqishmëria e deklaratës e të cilin gjë e ka pranuar si të rregullt edhe vet OSHP-ja. Këtu po shihet qartë se AK ka aplikuar standarde të dyfishta pasi që nuk po e zbaton nenin 59 të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit në mënyrë të barabartë për të gjithë tenderuesit.

Sipas asaj që e thotë neni 7 i LPP-së dhe krejt çka shihet tek ri-vlerësimi i AK-së, veprimi i tillë konsiderohet shkelje ligjore, trajtim jo i barabartë i tenderuesve dhe favorizim i OE-së që e ka shpallur fitues. Më detalisht për secilin gabim të AK-së që ka bërë gjatë këtij procesi të vlerësimit si dhe për çdo mangësi të OE të shpallur fitues, do ju njohim në pretendimet në vazhdim.

**3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së** pasi që gjatë rivlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç e parashihet në fjalë duke mos bërë vlerësim, sqarim dhe krahasim të drejtë të tenderuesve.

Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

**Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar**

**kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.**

E themi këtë sepse ashtu siç e sqaruar edhe tek pretendimi i kaluar shihet se AK e ka pranuar si të rregullt tenderin e OE që e ka shpallur fitues edhe pse i njëjti posedon mangësi të theksuara dhe shumë domethënëse në tenderin e tijë ndërsa neve prap na ka eliminuar me një arsyetim plotësisht të pabazuar dhe absurd për një gabim teknik dhe atë për një dokument përkatësisht dëshmi që nuk ishte kërkuar fare në dosjen e tenderit tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, e të cilin e ka arsyetuar dhe pranuar si të rregullt edhe vet OSHP.

Arsyeja e eliminimit të tenderit tonë edhe për të dytën herë duket kështu:

Gjatë procesit fillestar të vlerësimit të ofertave, Komisioni i Vlerësimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga OE "ROA Group L.L.C.", ka konstatuar mospërputhje në dokumentet deklarative, konkretisht në "Deklaratën mbi Specifikimin Teknik" dhe "Deklaratën e Liferimit", ku në të dyja dokumentet është vendosur titulli i aktivitetit: "FURNIZIM ME TRAKTOR PËR KOSITJEN E BARIT", ndërkohë që aktiviteti i prokurimit për të cilin është zhvilluar kjo procedurë ka titull tjetër.

Duke u bazuar në këtë, Komisioni kishte vlerësuar se deklaratat nuk i referohen kësaj procedure të prokurimit dhe si rrjedhojë kishte konsideruar ofertën si të papërgjegjshme, duke rekomanduar eliminimin e OE nga procedura.

I pakënaqur me këtë vendim, OE "ROA Group L.L.C." ka paraqitur ankesë në OSHP. Pas shqyrtimit të ankesës, eksperti i OSHP-së ka konstatuar se, përkundër gabimit në titullin e aktivitetit në këto dy deklarata, OE kishte përfshirë saktë të dhëna të tjera thelbësore si: numrin e prokurimit, numrin e brendshëm dhe emrin e Autoritetit Kontraktues. Sipas arsyetimit të ekspertit, numri i prokurimit paraqet një identifikues unik të aktivitetit dhe, duke qenë se këto të dhëna janë të sakta, gabimi në titull është vlerësuar si devijim i vogël (gabim minor), i lejuar sipas nenit 59, paragrafi 4 i Ligjit për Prokurimin Publik.

Si rrjedhojë, OSHP ka vlerësuar këtë pretendim si të bazuar dhe ka kthyer lëndën në rivlerësim. Autoriteti Kontraktues është pajtuar me vendimin e OSHP-së dhe ka vazhduar me procesin e rivlerësimit të ofertave.

Gjatë rivlerësimit, Komisioni i Vlerësimit ka analizuar përsëri dokumentacionin e OE "ROA Group L.L.C." dhe ka identifikuar një mospërputhje tjetër, më thelbësore, në dokumentin "Deklaratë Liferimi", i cili përbën një nga dokumentet kryesore administrative të ofertës. Përveç titullit të pasaktë të aktivitetit ("FURNIZIM ME TRAKTOR PËR KOSITJEN E BARIT"), në këtë deklaratë OE ka deklaruar tekstualisht:

"Kompania ROA GROUP L.L.C deklaron se pajisjet (Gjeneratori) të cilat ju janë ofertuar për këtë tender do të dorëzohen brenda periudhës prej 60 ditë kalendarike nga lëshimi i urdhërblertes nga ana e AK".

Komisioni vlerëson se kjo deklaratë është në kundërshtim të plotë me objektin e aktivitetit të prokurimit, i cili është:

"Furnizimi, instalimi dhe programimi i Ujëmatësit Digjital DN 400". Përmendja e "gjeneratorit" si pajisje e ofertuar tregon qartë se deklarata nuk i referohet këtij aktiviteti të prokurimit, por një aktiviteti tjetër krejtësisht të ndryshëm. Kjo nuk përbën më vetëm një gabim në titull, por një mospërputhje në përmbajtjen substanciale të deklaratimit.

Komisioni vlerëson se një devijim i tillë nuk mund të klasifikohet si gabim teknik apo lëshim i vogël administrativ në kuptim të nenit 59 të LPP-së, pasi ndikon drejtpërdrejt në natyrën e ofertës dhe krijon pasiguri serioze juridike lidhur me atë se çfarë produkti është ofertuar dhe për çfarë obligohet OE.

oblonget CE.

Dokumentet deklarative duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin përkatës të prokurimit. Në këtë rast, përmbajtja e deklaratës së liferimit nuk përkon me kërkesat e dosjes së tenderit dhe as me objektin e kontratës.

Për këto arsye, Komisioni i Vlerësimit vlerëson se oferta e OE "ROA Group L.L.C." nuk i përmbush kërkesat thelbësore të dosjes së tenderit dhe si e tillë konsiderohet e papërgjegjshme. Oferta e operatorit ekonomik për ujëmatësin elektromagnetik është vlerësuar si pjesërisht në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në Dosjen e Tenderit. Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar, konstatohet se operatori ekonomik ka përmbushur disa nga parametrat bazë teknikë, si: diametri DN400, presioni PN10, shkalla e mbrojtjes IP67, furnizimi me energji 24 VDC, kapaciteti maksimal i rrjedhjes si dhe posedimi i certifikimit CE. Megjithatë, oferta nuk i plotëson në tërësi kërkesat e përcaktuara në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pasi mungojnë ose nuk janë të specifikuara qartë disa elemente thelbësore, si në vijim:

Mundësia e transferimit të të dhënave deri në PLC me gjatësi kabloje deri në 50 m;  
Specifikat e instalimit, përfshirë numrin dhe dimensionin e bulonave si dhe vlerën e torque-it.  
Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit përkatësisht në Aneksin 1, ka kërkuar specifikime teknike të detyrueshme, për të cilat operatori ekonomik "ROA" ka dorëzuar vetëm katalogun me specifikat e produktit të ofruar, i cili nuk përmban të gjitha informacionet e kërkuara sipas specifikimit teknik.

Në përputhje me Udhëzuesin Nr. 002/2024 për plotësim-ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, theksohet se Autoriteti Kontraktues përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të produktit, ndërsa operatori ekonomik është i obliguar të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Mungesa e specifikimit teknik të plotë dhe e qartë për mallrat e ofruara konsiderohet mospërmbushje e kërkesave të Dosjes së Tenderit.  
Andaj, duke u bazuar në nenin 59 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, oferta e operatorit ekonomik nuk mund të konsiderohet plotësisht e përgjegjshme në aspektin teknik.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga Operatorët Ekonomikë që kanë aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit zgjatjen e validitetit të ofertës për 30 (tridhjetë) ditë, si dhe zgjatjen e sigurimit të tenderit për 60 (gjashtëdhjetë) ditë. Operatori Ekonomik X SH.P.K. ka reaguar brenda afatit të përcaktuar, duke konfirmuar pajtimin me kërkesën e Autoritetit Kontraktues dhe njëkohësisht ka bashkëngjitur dokumentacionin e kërkuar, duke përmbushur kështu të gjitha kërkesat e parashtruara. Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t' i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

**Arsyetimi** i tillë aq sa është i jashtëligjshëm dhe fare i pa arsyetuar, është edhe tendencioz sepse shihet qartë që AK pretendon për një mangësi që ishte thjesht një gabim teknik dhe shihet qartë se deklarata posedon mjaftueshëm të dhëna që tregojnë se bëhet fjalë pikërisht për tenderin adekuat ku edhe është ngarkuar. Ky arsyetim për anulim bëhet edhe më i jashtë ligjshëm kur dihet se në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale nuk ishte kërkuar fare ndonjë deklaratë lidhur me plotësueshmërinë e specifikimeve teknike andaj përpos që këtu po vlerësohet në kundërshtim me nenin 59.4.i dhe 59.4.ii të LPP-së, po vlerësohet edhe në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së pasi që po aplikohet një kërkesë që nuk ishte e përcaktuar paraprakisht tek pika 9.1&9.2 e FDT-së.

Nisur nga kjo, veprimi i AK-së duke na eliminuar nga konkurrenca pa të drejtë ligjore dhe pa një arsyetim apo argumentim faktik juridik dhe ligjor, konsiderohet shkelje e plotë e

kritereve të dosjes së tenderit dhe shkelje e plotë edhe e nenit 59.4.i dhe 59.4.ii të LPP-së. Ja si duket deklarata jonë:

## DEKLARATË MBI SPECIFIKIMIN TEKNIK

Për: **Komp. Rajon Ujësjellësit "Hidromorava" SH.A.**

Aktivitetin me titull: **"FURNIZIM ME TRAKTOR PËR KOSITJEN E BARIT"**

Nr i prokurimit	nuk ka-26-118-1-2-1
Nr i brendshëm	KRU 26 03 121

Kompania **ROA GROUP L.L.C** deklaron se pajisjet të cilat ju janë ofertuar dhe do të përdoren për këtë tender janë konform specifikave teknike të parashtruara nga Autoriteti Kontraktues si dhe në përputhshmëri me të gjitha aspektet dhe udhëzimet tjera në Aneksin 1 sipas dosjes së tenderit.



Date: 02.02.2026

**ROA GROUP L.L.C**

Adresa: Sallabajë-Lluzhan p.n, Podujevë

Numri unik identifikues: 811949364

Numri fiskal: 330523242

Telefoni: 048-262-424

Nga vet deklarata po shihet se ky është një gabim teknik pa asnjë dëm dhe se po shihet që përpos numrit të prokurimit dhe numrit të brendshëm që ndërlidhet saktë me procedurën adekuate, posedon edhe emrin e Autoritetit Kontraktues kujt i drejtohet dhe se është e ngarkuar së bashku me të gjitha dëshmitë tjera në tenderin përkatës. Nisur forma e dëshmisë së tillë, ky është vetëm një gabim i cili sipas nenit 59.4 të LPP-së konsiderohet gabim minor ose paqartësi e cila mund të korrigjohet pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë si dhe përmban vetëm devijim të vogël (minor) që nuk mund të shkaktoj ndryshim material ose devijim nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Kjo ka mundur të sqarohet lehtë sepse devijimi i tillë ka mundur të kuantifikohet si gabim i vogël dhe ka mundur të merret parasysh si devijim minor gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Vet fakti që edhe OSHP e ka arsyetuar dhe cilësuar gabimin e tillë si minorë si dhe deklaraten e tillë e ka konsideruar të pranueshme, tregon edhe më shumë se veprimet e

AK-së përpos që janë kundër ligjore, janë në kundërshtim edhe me rekomandimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së të dhëna përmes Vendimit nr. 2026/137 të OSHP-së.

Edhe sa i përket disa mangësive shtesë teknike që i ka përmendur AK që gjoja ekzistojnë tek tenderi jonë dhe tek karakteristikat teknike të ujëmatësit tonë, konsiderojmë se kjo është bërë vetëm sa për ta manipuluar mendimin tonë dhe të OSHP-së pasi që të gjitha këto të dhëna ndodhen tek katalogu që ne kemi paraqitur. Dmth. ora që ne kemi ofertuar është në përputhje të plotë me kërkesat teknike të AK-së dhe se tentimi për manipuluar kinse me mangësi të tilla konsiderohet shkelje e rëndë ligjore. Edhe sikur të mungonte ndonjë e dhënë eventuale teknike në katalog, AK do duhet që nëpërmes nenit 59.4 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë të cilat ne do ja jepnim menjëherë. Këtu vlen të thuhet se ne jemi të autorizuar ekskluziv nga vet prodhuesi dhe se kjo tregon që prodhuesi në fjalë mundet të prodhojë të gjitha llojet dhe modelet e orëve përfshi edhe laramanin e ndryshme të karakteristikave teknike të tyre. Pra s'ka asnjë logjikë që ora të ketë ndonjë mangësi teknike për deri sa ne kemi dhënë deklaratën që e njëjta d të jetë plotësisht siç ishte kërkuar. Këtu duhet cekur edhe faktin që prodhimi i tillë posedon certifikimet e nevojshme CE dhe ISO që e bëjnë një artikull mjaft të sigurt dhe kualitativ për qëllimin e përdorimit. Për çfarëdo sqarimi shtesë, ju lutem juve si OSHP që të na kontaktoni pa hezitim. Vet fakti që ne kemi dorëzuar Aneksin 1 të nënshkruar dhe vulosur, tregon se jemi deklaruar që produkti jonë i kompletuar andaj AK është dashur të kërkojë sqarim për çfarëdo informate q ata e kanë konsideruar se mungon apo do ishte e nevojshme ta kishin.

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nuk ka respektuar as kërkesat e dosjes së tenderit edhe kur e ka shpallur si fitues tenderuesin X SHPK pasi që tenderi i tijë posedon mangësi shumë të theksuara dhe domethënëse. Mangësitë po i renditim në vazhdim, ku për të cilat po paraqesin edhe argumente dhe dëshmi se si ato nuk do duhej pranoheshin në asnjë rrethanë si të rregullta.

**Mangësia 1;** - OE X SHPK ka dorëzuar autorizimin e prodhuesit por e njëjta nuk është e vulosur e as e nënshkruar nga prodhuesi. Një autorizim pa vulë të njomë dhe i pa nënshkruar në asnjë formë sipas ligjit të prokurimit nuk mundet të pranohet si i rregullt. Përpos kësaj autorizimi i tillë nuk është nënshkruar dhe lëshuar nga persona kompetent por është lëshuar nga një agjent i shitjeve që sipas hierarkisë së kompanisë nuk ka asnjë drejtë se ka të drejtë të lëshoj autorizime të tilla. Ky element e forcon edhe më shumë pretendimin që autorizimi pa nënshkrim dhe pa vulë është i papranueshëm e sidomos kur lëshohet nga persona jo kompetent. Ja dëshmia:

DATE 30.01.2026.

### Manufacturer Authorization

Dear Sirs,

#### WHEREAS

We ABB who are official producer of water meters and accessories having head office - factories at :

Address: Postal address:

Postfach 10 12 20

D-40832 Ratingen

Email: info@abb.com

do hereby state that the sole representative of the our company for territory of Kosovo for authorization to represent, sell, maintain and service of all our product range produced by our factory and also authorize at meterology agency to register our products under company name :

"X shpk "

"X shpk" , Pristina, Kosovo , (UNIK no. 810834904, Business no.71021378, Fis.no. 601059125)

Contract name and number :

Furnizimi, instalimi dhe programimi I Ujëmatësit Digjital DN 400, nuk ka-26-118-1-2-1

X sh.p.k. is solely authorized to submit all documentation for the purpose of which is to provide goods manufactured by us, and to subsequently negotiate and sign the Contract and authorize for selling of our products for territory of Kosovo .

Yours sincerely,

**Darko Hrga**  
Digitally signed by Darko Hrga  
DN: cn=Darko Hrga, o=ABB  
Abb Brown Soviet Ltd  
Date: 2025.01.30 12:50:05  
+0100

Darko Hrga, Sales specialist

**Mangësia 2;** - Kërkesa e AK-së përkatësisht e FDT-së ishte që kërkohej një Inxhinier i Elektroteknikës i cili do duhej të ishte i pajisur me Licencën A ose Programues i certifikuar. Kërkesa mandatore është që gjithsesi duhet të dorëzohet një Inxhinier i elektroteknikës ndërsa si mundësi apo variant është ofruar që i njëjti të jetë me Licencë A apo të jetë Programues i certifikuar. OE X SHPK ka dorëzuar një person që sipas disa certifikatave supozohet se është i certifikuar diku jashtë vendit si programues i certifikuar po që për të nuk është dorëzuar fare diplomë e inxhinierit. Certifikimi si programues nuk e ka nivelin e diplomës universitare andaj siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit del që ky person nuk e plotëson kushtin e kërkuar. Pa diplomën e inxhinierit kërkesa konsiderohet e pa plotësuar dhe OE në fjalë është i papërgjegjshëm. Ja si ishte kërkesa:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kërkesa 3.OE duhet të posedon staf Profesional si Një inxhinier të Elektroteknikës me Licencë A ose Programues të çertifikuar dhe dy Instalues dhe saldues të çertifikuar, për instalime të rrjeteve të ujësjellësit dhe të ujëmatësve.	Dëshmia 3 OE për Ing. Duhet të dëshmon për Licencën ( dëshmia e licencës, ndërsa për programuesin duhet të dëshmon me çertifikatën e kualifikuar , gjithashtu për dy instaluesit duhet të dëshmon me çertifikatën e kualifikuar, dhe I gjithë stafi të kenë kontratën e punës të nënshkruar nga të dy palet si dhe e vulosur nga punëdhënsi, ose parakontartë ku specifikohet qartë angazhimin në këtë projekt e nënshkruar nga te dy palet dhe e vulosur nga punëdhësi.
---	-----------	---	--

Pa diplomën e Inxhinierit të elektroteknikës, ky kriter është i paplotësuar dhe OE është i papërgjegjshëm.

**Mangësia 3;** - OE X SHPK ka dorëzuar si staf dy instalues të ujit por ka dështuar të dorëzojë edhe dy saldues siç i ka kërkuar AK. Ja si ishte kërkesa e parashtruar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kërkesa 3.OE duhet të posedon staf Profesional si Një inxhinier të Elektroteknikës me Licencë A ose Programues të çertifikuar dhe dy Instalues dhe saldues të çertifikuar, për instalime të rrjeteve të ujësjellësit dhe të ujëmatësve.	Dëshmia 3 OE për Ing. Duhet të dëshmon për Licencën ( dëshmia e licencës, ndërsa për programuesin duhet të dëshmon me çertifikatën e kualifikuar , gjithashtu për dy instaluesit duhet të dëshmon me çertifikatën e kualifikuar, dhe I gjithë stafi të kenë kontratën e punës të nënshkruar nga të dy palet si dhe e vulosur nga punëdhënsi, ose parakontartë ku specifikohet qartë angazhimin në këtë projekt e nënshkruar nga te dy palet dhe e vulosur nga punëdhësi.
---	-----------	---	--

Mungesa e dy salduesve ose të paktën dëshmimi që vet ujë instaluesit janë edhe saldues të çertifikuar, kriteri nuk konsiderohet i plotësuar ndërsa OE konsiderohet i papërgjegjshëm. AK ka theksuar se gjoja Programuesi i çertifikuar është i pajisur edhe me çertifikatë të saldimit, por ligjërisht një person nuk mundet të i plotësojë dy pozita të ndryshme të punës si dhe aty janë kërkuar dy saldues ndërsa ky është vetëm një person që posedon çertifikatë për saldues. Nga kjo shihet se ky OE nuk ka arritur të paraqes numrin e salduesve të kërkuar pasi që ishin kërkuar dy saldues dhe ky OE kushtimisht e posedon vetëm një saldues.

Bazuar në krejt këtë, shihet se OE i shpallur fitues ka pasur shumë mangësi në tenderin e tij që tregojnë qartë se nuk është i përgjegjshëm, ndërsa veprimi i AK-së për eliminimin e

tenderit tonë me arsyetim kaq të pa bazuar, konsiderohet shkelje e plotë e ligjit, kriterëve të dosjes së tenderit si dhe vet rekomandimit të OSHP-së. Përpos kësaj, ky veprim konsiderohet edhe aplikim selektiv i kërkesave të dosjes së tenderit, aplikim i standardit të dyfishtë për sa i përket plotësueshmërisë së kërkesave nga OE e që krejt kjo konsiston me shkelje të plotë të nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke favorizuar hapur tenderuesin që e ka shpallur fitues dhe duke na diskriminuar në mënyrë shumë tendencioze neve dhe tenderin tonë.

**4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së** pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka vlerësuar drejt sipas kriterit të paraqitur në dosje të tenderit. Me që po shihet se ne jemi tenderues i përgjegjshëm dhe kemi edhe çmimin më të ulët në krahasim me konkurrencën, i bie se AK përpos që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka respektuar as kriterin e vlerësimit që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**.

Krejt kjo ka ardhur si pasoj e asaj kur AK e ka konsideruar të përgjegjshëm OE të shpallur fitues edhe pse i njëjti ka shumë mangësi në tenderin e tij ndërsa neve pa asnjë të drejtë na ka eliminuar nga konkurrenca e mëtutjeshme. Mos respektimi i neneve tjera siç është neni 7 dhe 59 i LPP-së e shtynë AK-në drejt shkelje së plotë të nenit 60 të LPP-së.

**5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së** pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat veta sipas nenit 69 të LPP-së. AK ka vendosur vet kërkesa teknike që lidheshin me nenin 69 të LPP-së por që gjatë vlerësimit nuk i ka zbatuar si duhet. Kërkesat për përshtatshmërinë profesionale që janë kërkuar nga AK shihet se ky i fundit i ka keq aplikuar kur ishte në pyetje vlerësimi i tenderit tonë ndërsa i ka anashkaluar plotësisht ato kur e ka vlerësuar tenderin e OE të cilin më pas pa asnjë të drejtë ligjore e ka shpallur edhe fitues. Këtu përpos që kemi të bëjmë me mos aplikim të drejtë të kriterëve të dosjes dhe kërkesave të nenit 69 të LPP-së e të përcaktuara tek kërkesat e FDT-së dhe tek specifikim teknik, kemi të bëjmë edhe aplikim të një kërkesë që nuk ishte fare tek pika 9.1&9.2 e FDT-së si dhe me një favorizim të hapur të një OE plotësisht të papërgjegjshëm. Edhe kontestimi i disa të dhënave teknike, nuk përputhet me realitetin pasi që si karakteristika janë të paraqitura në katalogun e dorëzuar.

**6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së** pasi që gjatë ri vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime tek ne për të vërtetuar se gabimi në deklaratën e tillë është vetëm gabim teknik dhe se ajo e plotëson mjaftueshëm qëllimin për çka ishte dorëzuar. Këtu shihet qartë mos aplikimi i drejtë nenit 72 ku për neve nuk e merr fare mundimin të na kërkoj sqarime shtesë për deklaratë që nuk ishte kërkuar fare tek pika 9.1 & 9.1 – Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale, ndërsa OE që e ka shpallur fitues shihet se ia ka pranuar shumicën e dëshmimeve si të parregullta dhe të mangëta

**7. AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së** pasi që gjatë ri vlerësimit nuk ka respektua si duhet vendimin e OSHP-se përkatësisht rekomandimin e tyre ku për pasoj ka nxjerrur prap vendim të pa ligjshëm.

Veprimet e tilla përpos që konsiderohen shkelje e nenit 7 të LPP-së, konsiderohen aplikim selektiv i mundësisë dhe shkelje e plotë e nenit 72 të LPP-së.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që u thanë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr:

### **V E N D I M**

**APROHOHET** si e bazuar ankesa e **OE "ROA Group L.L.C."** lidhur me tenderin **"Furnizimi, instalimi dhe programimi I Ujëmatësit Digjital DN 400"** i iniciuar nga **Komp. Rajon Ujësjellësit "Hidromorava" SH.A.**

**ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK - **Komp. Rajon Ujësjellësit "Hidromorava" SH.A.** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim**.

**Ri-vlerësimi** të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit e sidomos ato të specifikimit teknik, që realisht më pas do duhej që **FITUES** të shpallej **OE "ROA Group L.L.C."**.








## **9. Dëmet materiale**



















*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim dhe kontratë.

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

-  1 Njoftim per Kontrat
-  2 Template per Dosja e Tenderit Furnizim me ujëmatës digjital DN 400- në gj.Shqipe
-  3 Përshkrimi i çmimit furnizim me ujëmatës digjital DN 400
-  4 foto ujematesi
-  5 PYETJE DHE PERGJIGJJE-Furnizim me ujëmatës digjital
-  6 Procesverbal i hapjes-Furnizim me ujemates 400
-  7 Njoftimi mbi vendimin e AK dhe letrat satndarde Furnizim me ujemates 400

-  8 KERKESE PER QASJE NE DOKUMENTACION
-  9 Qasje ne Dok 23.02.2026
-  11 Lista e cmimeve X SHPK
-  12 Deklerata nen betim Dn 400 X SHPK
-  13 Lista e projekteve dhe referencave te X SHPK 19.12.2025 X SHPK
-  14 Deklerata 3.1 per spec. teknike - afati i furnizimeve X SHPK
-  15 ABB AG flowmeter DN 400 X SHPK
-  16 MAF-X sh.p.k-WaterMaster X SHPK
-  17 Stafi per projekt - X SH.P.K
-  18 Deklarata e specifikave ROA GROUP SHPK
-  19 Kerkese per Rishqyrtim - KRUH - ROA GROUP SHPK - 24.02.2026
-  20 Vendim kunder pergjigjes per rishqyrtim ROA
-  21 ANKESE - ROA Group LLC - 06.03.26
-  22 Raporti\_Ekspertit\_2026 0139
-  23 Vendimi\_2026 0137
-  24 Njoftimi mbi vendimin e AK dhe letrat standarde Furnizim me ujemates 400 -Rivleresim
-  25 KERKESE PER RISHQYRTIM - KRUH - ROA GROUP LLC 05.05.2026
-  26 Vendimi kunder kerekses per rishqyrtim ROA 12.05.2026

**Vërejtje:** Të gjithë materialin që i kemi mbështetur pretendimet tona e gjeni të bashkangjitur por i njëjti është edhe në materialin e procedurës së prokurimit që ndodhet në AK.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*